

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga 50 mijë në afro 1 milion euro: sendet e Brigitte Bardot thyejnë pritshmëritë në ankand
ADRESA	https://piranjat.al/showbiz/nga-50-mije-ne-afro-1-milion-euro-sendet-e-brigitte-bardot-t-hyejne-prits-i105518
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:04:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 18:57:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	259e9c9f881ccbe7d23ee7caadedcb1c65e2c21db999936da74cb1a9db9e4c32
TEKSTI	bda1093ab6ba6feaa225125a42c8962bb7c2c0404ca218d9912e90cdd881e333
PAMJA	106bdc4a04ba96260d943405aab79584624975d7826371998b7995b683fcac39

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	03a973d7ace0d55f07d365c4c0ff3f0badf5b6a3291885bb0ff8312eb19f777d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/03a973d7ace0d55f07d365c4c0ff3f0badf5b6a3291885bb0ff8312eb19f777d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [SHISH](#) e Drejtorit të Shër... ■ [Piranjat: Avokatin nuk e](#) mundohet të Bleona Matës dhe pretendimeve ■ [Vlora Hyseni](#) të GJKKO-së për çaktimin ■ [kush është trafikanti](#) ndërsa merrte pjesë në ceremoninë ■ [trajton rastet e korrupsionit](#) dyshimin për...

[SHOWBIZ](#)

Nga 50 mijë në afro 1 milion euro: sendet e Brigitte Bardot thyejnë pritshmëritë në ankand

Piranjat Përditësimi i fundit 22 Shtator 2026, 20:57

[info](#) @rtlinfo · Follow

Quasiment un million d'euros : une vente aux enchères d'objets appartenant à Brigitte Bardot fait un carton



rtl.be

Quasiment un million d'euros : une vente aux enchères d'objets apparte...
La vente aux enchères des objets personnels de Brigitte Bardot a atteint près de 954.000 euros, vingt fois l'estimation. Des souvenirs de la star o...

8:36 AM · Sep 22, 2026

Sendet personale të Brigitte Bardot kanë marrë një vlerë të jashtëzakonshme në ankandin e zhvilluar në Paris, ku 285 objekte të aktorese famshme franceze u shitën për afro 1 milion euro.

Sipas shtëpisë së ankandeve Millon, rezultati final ishte rreth 20 herë më i lartë se vlerësimi fillestar, i cili ishte rreth 50 mijë euro. Në ankand morën pjesë rreth 3 mijë persona nga Franca dhe vende të ndryshme të botës.

Koleksioni përfshinte sende që Bardot kishte mbajtur në banesat e saj në Paris dhe Saint-Tropez, mes tyre veshje, kapele, syze dielli, mobilje dhe enë tavoline. Disa prej objekteve, megjithëse kishin një vlerësim modest, përfunduan me çmime shumë më të larta.

Një prej rasteve më të veçanta ishin dy qafore qensh me emrin e Bardot. Të nisura nga vetëm 30 euro, ato u shitën për 9,400 euro, duke përfunduar në duart e një ofertuesi nga Rusia.

Edhe objektet e tjera të koleksionit tërhoqën interes të madh. Një portret i aktorese u shit për afro 40 mijë euro, ndërsa makina e shkrimit që ajo përdori për të shkruar autobiografinë e saj arriti çmimin 4,634 euro. Dy kitara u shitën për 8,600 dhe 1,900 euro, ndërsa tre lodra prej pelushi u blenë për një total prej 2,200 eurosh.

Ankandisti Alexandre Millon e përshkroi rezultatin si të jashtëzakonshëm, duke theksuar diferencën mes vlerësimit fillestar dhe shumës së mbledhur.

"Brigitte Bardot vërtetoi edhe një herë se është një alkimiste e jashtëzakonshme. Ajo i shndërroi vlerësimet prej rreth 50,000 eurosh në pothuajse 1 milion euro, duke përfshirë komisionet", deklaroi Millon.

Të ardhurat nga shitja do të përdoren nga Fondacioni Brigitte Bardot për aktivitetet në mbrojtje të kafshëve, ndërsa një pjesë e shumës do t'i kalojë djalit të aktorese, Nicolas-Jacques Charrier.

Sipas drejtueses së fondacionit, Ghislaine Calmels, kjo nismë lidhet me një tjetër shitje të organizuar nga vetë Bardot në vitin 1987 për të mbështetur kauzën e saj në mbrojtje të kafshëve.

Megjithatë, ankandi nuk kaloi pa polemika. Bernard d'Ormal, bashkëshorti i fundit i Bardot, kundërshtoi publikisht shitjen e sendeve private, duke argumentuar se ato duhej të ishin ruajtur si pjesë e trashëgimisë së aktorese.

Fondacioni e kundërshtoi këtë qëndrim, duke sqaruar se shitja ishte miratuar nga bordi i drejtorëve në qershor, në një kohë kur d'Ormal ishte ende në krye të institucionit. Debati u bë publik vetëm pak ditë pasi ai u largua nga drejtimi i fondacionit, post të cilin e kishte mbajtur që prej ndarjes nga jeta të Brigitte Bardot.

Artikuj te sugjeruar

SHOWBIZ 22 Shtator19:23

[Mateo dhe Brikena do të bëhen prindër? Modelja vendos pikat mbi “i” për aludimet mbi shtatzëninë](#)

Ish-banorja e “BBVA5”, njëherazi dhe modelja e njohur nga Kosova, Brikena Selmani së fundi është përfolur se është&eu...

SHOWBIZ 22 Shtator18:18

[Teze për herë të dytë, Era Istrefi publikon momentin emocionues me mbesën e sapolindur](#)

Era Istrefi ka ndarë me ndjekësit një moment të veçantë familjar, teksa është bërë teze për herë...

SHOWBIZ 22 Shtator18:11

[U nda nga jeta tragjikisht në moshën 36-vjeçare, zbulohet shkaku i vdekjes së aktores së njohur amerikane Hayden Panettiere](#)

Aktorja 36-vjeçare ndërroi jetë më 16 gusht në apartamentin e saj në Karolinën e Jugut. Mjeku ligjor e cilësoi vdekjen...

SHOWBIZ 22 Shtator16:12

[Jonida Maliqi flet për marrëdhënien me ish-banorin e “Big Brother VIP 5”: Më kthen fëmijën që kam brenda](#)

Këngëtarja Jonida Maliqi ka qenë e ftuar në “Live From Tirana”, ku ka folur për marrëdhënien e saj me ish-banorin...

SHOWBIZ 22 Shtator15:11

[Nga Bora Zemani te Heidi Baci, 4 moderatore të kanë drejtuar “Për’puthen” ndër vite](#)

“Për’puthen” ka nisur një tjetër kapitull. Emisioni i dashurisë në Top Channel është rikthyer në ekr...

SHOWBIZ 22 Shtator15:06

[“Meritoje më shumë kohë”/ Ish-e dashura e Presley Gerber përlot me dedikimin prekës](#)

“Meritoje më shumë kohë. Meritoje më shumë jetë. Jam shumë e zemëruar për këtë”. Janë ...

SHOWBIZ 22 Shtator14:57

[Buzë me ngjyrë perfekte dhe që zgjat gjithë ditën, 9 lip stain-et që po bëjnë namin](#)

Lip stain është bërë një nga produktet më praktike për ato që duan buzë me ngjyrë të bukur dhe qën...

SHOWBIZ 22 Shtator14:32

[Strakosha rrëfen për herë të parë për aneurizmën cerebrale: Gjithçka nisi me një dhimbje koke shumë të fortë](#)

Gazetari dhe moderatori Bled Strakosha ka rrëfyer për herë të parë në “Live From Tirana” detajet e përballjes s...

SHOWBIZ 22 Shtator10:43

[Këngëtarin ndërroi jetë në një klinikë private/ Nëna e George Mazonakis kërkon drejtësi: Për kujtimin e fëmijës tim të dashur](#)

Nëna e këngëtarit George Mazonakis, Cleo, ka folur për mediat greke pas humbjes së djalit të saj, duke shprehur dhimbjen e madhe d...

SHOWBIZ 21 Shtator22:24

[“Kisha dëgjuar që nuk ishte mirë”/Takimi i veçantë mes Mira Konçit dhe Parashqevi Simakut](#)

Shqiptarët, sidomos ata që jetojnë në Amerikë, janë familjarizuar tashmë me historinë e këngëtares së mad...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 22 Shtator

[Shkuan për t’i blerë dhuratën të ëmës për ditël...](#)

Tri motra humbën jetën pasi një zjarr përfshiu një qendër tregtare, duke detyruar klientët e tmerruar të hidheshin nga d...

AKTUALITET 22 Shtator

[Aksioni i SPAK/ Kontrolle dhe në bazat e Tropi...](#)

Të tjera detaje kanë dalë në dritë nga operacioni i SPAK, i ndërmarrë paraditen e kësaj të marte. Raportohet se ...

AKTUALITET 22 Shtator

[A është cenuar siguria kombëtare? SPAK lëshoi “...](#)

SPAK lëshoi sot masën e sigurisë ‘arrest shtëpie’ për kreun e SHISH, Vlora Hyseni, e cila po hetohet për skandalin e...

INVESTIGIME 19 Shtator14:14

[Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës](#)

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1






PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1




“Dua 120 mijë euro”? Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.